

Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar

Rr. "Muhamet Gjollesha", Sheshi Mustafa Q. Atatürk, ish 21 Dhjetori, Tiranë / P.O. Box 63
Tel: +355 4 2235 249 / 2240 602 • Fax: +355 4 2240 565
<http://www.nocalbania.org.al> • E-mail: secretariat@nocalbania.org.al

Aneks 14

Tiranë, 25 Janar 2018

NGA MBLEDHJA E KOMITETIT EKZEKUTIV TË KOKSH Nr. 1/2018

Zhvilluar sot, ditën e Enjte, dt. 25 Janar 2018, në zyrat e KOKSH, ora 15.30,
u mbajt mbledhja e thirrur nga Presidenti Viron Bezhani në prezencë të anëtarëve :

1. Viron Bezhani
2. Vojo Malo
3. Genc Boga
4. Erlind Pëllumbi
5. Ilir Gusho
6. Koco Mikerezi
7. Labo Capo
8. Majlinda Pilinci

Mungonin pas njoftimit :

9. Ela Tase
10. Agron Cuka
11. Renis Tërshana

Mori pjesë në mbledhje Sekretari Përgjithshëm Stavri Bello.

Mbajti procesverbalin: Enkelejda Caushi

Rendi i dites :

1. Miratim i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.
2. Informacion mbi Lojërat Olimpike Dimërore Pyeong Chang 2018
3. Informacion mbi aktivitetin " 10 sportistët më të mirë të vitit"
4. Organizime për "60 vjetorin e krijimit të KOKSH " (23 qershor 1958-2018).
5. Informacion mbi çështjet e diskutuara nga mbledhja e Komisionit Teknik datë 24 Janar 2018
6. Projekti "Talentet e Reja", diskutim i rastit të Federatës së Notit
7. Të ndryshme





Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar

Rr. "Muhamet Gjollësia", Sheshi Mustafa Q. Atatürk, ish 21 Dhjetori, Tiranë / P.O. Box 63

Tel: +355 4 2235 249 / 2240 602 • Fax: +355 4 2240 565

<http://www.nocalbania.org.al> • E-mail: secretariat@nocalbania.org.al

Anex 14/1

Pika 1. Miratim i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.

Pas diskutimeve u miratuan procesverbalet e mbledhjeve të kaluara me shënimet përkatëse.

Pika 2. Informacion mbi Lojërat Olimpike Dimërore "Pyeong Chang 2018"

Bello informoi të pranishmit në lidhje me masat e marra për organizimin e Ekipit Olimpik në Lojërat Olimpike Dimërore Pyeongchang 2018. Ai sqaroi se kemi pasur vështirësi komunikimi me Federatën e Skive, që nuk na është përgjigjur në zgjidhjen e shumë problemeve, të cilat duhet të sqarohen nga federata por i janë transferuar KOKSH-it për zgjidhje.

Dy sportiste dhe dy trajnerët do të vijnë në Shqipëri për të marrë pjesë në ceremoninë e dorëzimit të flamurit tek Presidenti datë 2 shkurt 2018.

Pas diskutimeve në lidhje me masat organizative u mor unanimisht vendimi si më poshtë:

Vendimi 1/ 2018

Komiteti Ekzekutiv vendosi që flamur mbajtësja për ceremoninë e parakalimit të Ekipit Olimpik Shqiptar të jetë Suela Mëhilli

Pika 3. Informacion mbi organizimin e aktivitetit të Sportistit më të mirë të vitit 2017


Në këtë pikë të rendit të ditës Sekretari Përgjithshëm z. Bello informoi të pranishmit se RTSH Sport ka marrë përsipër të trasmetojë live spektaklin dhe do të bashkëpunojë për regjinë e tij.

Anëtarët e Komitetit Ekzekutiv u njohën me listën e sportistëve të propozuar nga federata. Secila ka sjellë dy sportistë dhe janë 11 federata nga të cilat njëra është Radioamatorizmi jo Olimpik.

Në vazhdim u diskutuan çështjet:

- Të premiohen vetëm sportistët e federatave olimpikë
- Të mos merren parasysh propozimet e Federatës së Peshëngritjes pasi të dy emrat janë të dënuar për doping dhe këto emra nuk mund të promovohen nga KOKSH, bazuar në politikën e antidopingut dhe parimeve të qeverisjes së mirë dhe të Kodit të Etikës së IOC.





Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar

Rr. "Muhamet Gjollësia", Sheshi Mustafa Q. Atatürk, ish 21 Dhjetori, Tiranë / P.O. Box 63
Tel: +355 4 2235 249 / 2240 602 • Fax: +355 4 2240 565
<http://www.nocalbania.org.al> • E-mail: secretariat@nocalbania.org.al

Aneks 14/2

- Të pranohet vetëm një emër për federatë, ndërsa federatat cilësore të lihen me dy emra;

Morën pjesë në diskutime zotërinjtë Malo, Bezhani, Bello, Pëllumbi, Gusho, Boga, Capo, Mikerezi, Pilinci.

Pas diskutimeve u mor unanimisht vendimi si më poshtë

Vendimi 2/2018

Aktiviteti "Sportistët më të mirë të vitit" do të realizohet në bashkëpunim me RTSH Sport datë 20 shkurt 2018, Hotel Sheraton, Ora 18.30.

Nga lista e propozimeve Komiteti Ekzekutiv vendosi të promovohen një sportist për çdo Federatë Olimpikë e propozuar, sipas renditjes nga vetë federatat, duke mos përfshirë sportistët e dënuar me doping. Të përfshihet në listë dhe një futbollist duke i kërkuar dhe një herë një propozim Federatës së Futbollit.

Pika 4. Organizime për 60 vjetorin e krijimit të KOKSH (23 nëntor 1958-2018)

Pas diskutimeve në lidhje me këtë event, anëtarët e Komitetit Ekzekutiv morrën unanimisht vendimin e mëposhtëm:

Vendimi 3/2018

Të filloj promovimi i këtij eventit dhe të pregatitet një plan eventesh deri në datën 23 nëntor 2018.

Pika 5 dhe 6.

Informacion mbi çështjet e diskutuara nga mbledhja e Komisionit Teknik datë 24 janar 2018 dhe Projekti Talenteve të Reja, diskutim i rastit të Federatës së Notit


Në këtë pikë të rendit të ditës Kryetari i Komisionit Teknik z. Koco Mikerezi informoi të pranishmit në lidhje me diskutimet e bëra në mbledhjen e Komisionit Teknik mbajtur datë 24 Janar.

Ai informoi mbi Planin e punës së Komisionit.

Në vazhdim paraqiti vendimin e marrë nga Komisioni Teknik në lidhje me rastin e Federatës Shqiptare të Notit.

Komiteti Ekzekutiv miratoi unanimisht vendimin e mëposhtëm:





Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar

Rr. "Muhamet Gjollësia", Sheshi Mustafa Q. Atatürk, Ish 21 Dhjetori, Tiranë / P.O. Box 63

Tel +355 4 2235 249 / 2240 602 • Fax: +355 4 2240 565

<http://www.nocalbania.org.al> • E-mail: secretariat@nocalbania.org.al

Aneks 14/3

Vendimi 4/2018

Në bazë të propozimit të ardhur nga Federata Shqiptare e Notit dhe analizës së këtij rasti në Komisionin Teknik, Komiteti Ekzekutiv vendosi që sportistes Alesia Neziri, përfituese e Projektit Talentet e Reja, ti ndërpritet bursa, nga momenti i marjes së vendimit nga Federata. Të njoftohet Federata për kthimin e pjesës së mbetur të bursës dhe mbyllja e Raporteve Financiare dhe Teknike.

Në këtë pikë të rendit të ditës nga Znj. Pilinci u diskutua çështja e një fondi për realizimin e një studimi në lidhje me talentet e reja, pasi është e rëndësishme zbulimi i talentëve. Z. Boga e mbështeti këtë propozim por është e rëndësishme të bashkëpunohet me qendrën kërkimore dhe vecanërisht me federatat sportive për përcaktimin e kriterëve pasi KOKSH nuk mund të ndjekë dhe të realizoj vetë këtë procedurë.

Pika 7. Të ndryshme

A. Paga të stafit të KOKSH

Z. Genc Boga me detyrën e Trezorierit bëri me dije Anetarëve të Komitetit Ekzekutiv se për arsye të rregullimeve financiare të detyrimeve me tatimet në pagat e stafit, pjesa shtesë që jepet nga Solidariteti Olimpik në vlerën neto është zvogëluar pasi është rritur tatimi. Për këtë arsye propozoj që pjesa neto e pagesës së stafit të mos ndryshojë dhe të mos ketë humbje për arsye të tatimit, por të rritet paga shtesë në proporcion me tatimin.

Gjithashtu në vazhdim Z. Boga spjegoi se stafi ka disa vite që nuk ka rritje page ndaj dhe është e justifikueshme të ketë në këtë fillim viti një rritje page që mund të jetë 5 deri 10%.

Z. Boga propozoi si rritje të arsyeshme vlerën 10% të rritje së pagës.

Presidenti Bezhani gjithashtu mbështeti këtë propozim për rritje 10% të pagës.

Morën pjesë në diskutime gjithashtu zotërinjtë Mikerezi, Pilinci dhe Gusho. Z. Gusho propozoi një rritje prej 15% të pagës.

Pas diskutimeve u miratuan unanimisht vendimet e më poshtëme:

Vendimi 5/2018

“Komiteti Ekzekutiv vendosi që pjesa neto e pagës shtesë që merr stafi nga fondi i Solidaritetit Olimpik të mos ndryshojë dhe të mos preket nga rritja e tatimit, por të rritet vlera bruto në përputhje me tatimin.”

Vendimi 6/2018

“Komiteti Ekzekutiv vendosi që paga e stafit që merret nga fondin grant nga Ministria së bashku me pagesën që merret nga fondi i Solidaritetit Olimpik në total të rritet në vlerën 10%.”





Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar

Rr. "Muhamet Gjollësia", Sheshi Mustafa Q. Atatürk, ish 21 Dhjetori, Tiranë / P.O. Box 63
Tel: +355 4 2235 249 / 2240 602 • Fax: +355 4 2240 565
<http://www.nocalbania.org.al> • E-mail: secretariat@nocalbania.org.al

Aneks 14/4

B. Projekti "Mjell një Pemë"

Z. Bello bëri me dije Anëtarët e Komitetit Ekzekutiv në lidhje me projektin e Bashkisë "Mbjell një pemë" dhe propozoi që dhe KOKSH të jetë pjesë e kësaj nisme duke mbjellë pemë ullinj në emër të mbajtësve të urdhërave Olimpik që KOKSH ka dhënë në vite. Në vazhdim anëtarët e Komitetit Ekzekutiv miratuan unanimisht vendimin e mëposhtëm:

Vendimi 7/2018

KOKSH i bashkohet nismës së Bashkisë Tiranë me projektin "Mbjell një Pemë", për të mbjellë nga një pemë ulli në emër të personave që janë mbajtës të Urdhërit Olimpik gjatë viteve të dhëna nga KOKSH. Në vazhdim stafi i KOKSH do të marrë masat administrative në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë.

C. Kontratë sponsorizimi.

Anëtarët e Komitetit Ekzekutiv u njoftuan në lidhje me nënshkrimin e Kontratës së Sponsorizimit me Kompaninë Kineze New Bulenera, e cila do të jetë sponsor i uniformave sportive të Ekipit Olimpik Shqiptar për Tokyo 2020. Kontrata do të filloj të ketë zbatim që nga viti 2018 sipas Aneksave në sasi të përkatëse të rëna dakort. Aktualisht po punohet për modelet e personalizuara të uniformave.

Komiteti Ekzekutiv u njoh me modelet e paraqitura dhe u ra dakort të miratohen modelet e uniformave që përmbajnë ngjyrat kuq e zi.

D. Kërkesa për mbështetje financiare

Z. Bello informoi të pranishmit se kanë ardhur kërkesa për mbështetje financiare nga Federatat e Tenisit, Mundjes dhe Zhytjes, por ka vetëm kërkesa zyrtare dhe nuk është plotësuar me aplikim dhe dokumentacion përkatës. Komiteti Ekzekutiv ra dakort që kërkesat të plotësohen dhe të dorëzohen në mbledhjen e ardhshme.

Duke qenë se çështjet e rendit të ditës u diskutuan të gjitha, Presidenti i KOKSH mbylli mbledhjen, duke falenderuar Anëtarëve e Komitetit Ekzekutiv për prezencën dhe kontributin

VIRON BEZHANI
PRESIDENT

STAVRI BELLO
SEKRETAR PËRGJITHSHËM

